

Përshëndetje Z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës suaj Nr. 163/18 Prot, datë 05.06.2018, protokolluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me Nr. 1290, datë 08.06.2018, brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ju sqarojmë sa vijon:

### **Lidhur me pikën Nr.1.**

Caktimi i avokatëve kryesisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës bëhet në bazë të listës së gadishmërisë e cila vihet në dispozicion nga Kryetari i Dhomës së Avokatisë Durrës. Kjo listë azhurnohet çdo 3 muaj.

Për vitin 2016 në listë kanë qenë të gatshëm rreth 33 (tridhjetë e tre) avokatë të gatshëm.

Për vitin 2017 në listë kanë qenë të gatshëm rreth 63 (gjashtëdhjetë e tre) avokatë të gatshëm.

### **Lidhur me pikën Nr.2.**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2016 ka gjykuar gjithsej 6502 çështje nga të cilat 3876 çështje civile dhe 2626 çështje penale.

Sa i përket numrit të çështjeve ku janë caktuar avokatë kryesisht Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore me të cilën operon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk mundëson nxjerrjen e këtyre të dhënave, por sistemi financiar Alphaweb na mundëson të dhëna që lidhen me numrin e faturave të avokatëve kryesisht (një faturë mund të përfshijë më shumë se një çështje) të likujduar gjatë viteve.

Sipas sistemit financiar Alphaweb numri i faturave të likujduara gjatë vitit 2016 ka qenë 252 dhe 226 fatura për vitin 2017.

### **Lidhur me pikën Nr.3.**

Buxheti dhe disbursimi për avokatët e caktuar kryesisht për vitin 2016 ka qenë 4 287 275 (katërmilion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë), buxhet me të cilin janë likujduar 100% të faturave jo vetëm viti 2016 por dhe cdo detyrim i prapambetur i viteve të mëparshme.

Buxheti dhe disbursimi për avokatët e caktuar kryesisht për vitin 2017 ka qenë 2 149 000 (dymilion e njëqind e dyzetë e nëntë mijë), buxhet me të cilin janë likujduar 100% të faturave.

Aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka asnjë detyrim të prapambetur apo faturë të pa likujduar që lidhet me shërbimin e avokatëve të caktuar kryesisht.

Gjithashtu theksojnë se bazuar në Ligjin nr.7928, date 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 13, personi që kryen një shërbim të tatueshëm duhet të lëshojë faturë tatimore në momentin kur shërbimet janë kryer prej tij. Në kuptim të këtij ligji, avokati i thirrur kryesisht nga gjykata, jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së vendimit gjyqësor apo data e vërtetimit të lëshuar nga gjyqtari i çështjes (sipas rastit), duhet të plotësojë faturën tatimore për shërbimin e ofruar.

Mosparaqitja e faturës tatimore nga ana e avokatit sipas përcaktimit në Ligjin nr.7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, përbën shkak për mos kryerjen e pagesës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare pranë kësaj Gjykate si dhe me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të integruara, garanton ndihmë ligjore **falas** për shtresat në nevojë dhe për të miturit në konflikt me ligjin. Në këto kushte ulen dhe shpenzimet për pagesat e avokatëve dhe psikologëve të caktuar kryesisht.

Ju uroj ditë të mbarë!

**Henri Hatillari**

Specialist IT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Lagjia Nr.2 Rruga "Aleksandër Goga" Durres

Mob : 069 37 76 711

E-mail: [henri.hatillari@gjykata.gov.al](mailto:henri.hatillari@gjykata.gov.al)

Web: [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)